



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETEQEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrët

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV
NUMËR: MASHT 15/2007
DATË: 1.8.2007

LËNDA: **KALENDARI PËR VITIN SHKOLLOR 2007 / 2008**

Në bazë të nenit 13.2 (a) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, si dhe nenit 1.3 (ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë:

Udhëzim Administrativ

Neni 1
Qëllimi

1.1 Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike, për nxënësit e shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta, të shkollave të mesme të larta dhe për fëmijët parafillor.

Neni 2
Viti shkollor

2.1 Viti shkollor 2007 / 2008, do të fillojë më 3 shtator 2007 dhe do të mbarojë më 31 gusht 2008.

Neni 3
Gjysmëvjetori

3.1 Gjysmëvjetori i parë fillon më 3 shtator 2007 dhe mbaron më 20 dhjetor 2007

3.2 Gjysmëvjetori i dytë fillon më 8 janar 2008 dhe mbaron më:

- 12 maj 2008, për nxënësit të cilët e mbarojnë shkollën e mesme të lartë me klasën e 12-të ose të 13-të,
- 2 qershor 2008 për nxënësit e klasave prej 9 – 12-të
- 16 qershor për nxënësit e klasave 1 – 8 dhe fëmijët parafillor.

Neni 4

Praktika profesionale

4.1 Përveç mësimit të rregullt, nxënësit do të kenë edhe forma tjera të mësimit siç është mësimi praktik dhe praktika profesionale.

4.2 Të gjithë drejtorët e shkollave profesionale janë të detyruar që në planin vjetor të punës ta caktojnë kohën e mbajtjes së praktikës profesionale.

Neni 5

Pushimet

5.1 Pushimi dimëror fillon më 20 dhjetor 2007 dhe mbaron më 7 janar 2008.

5.2 Pushimi pranveror fillon më 24 mars 2008 dhe mbaron më 28 mars 2008.

Neni 6

Festat publike

- Fitër Bajrami, festohet më 12 tetor 2007
- Dita e Flamurit, festohet më 28 nëntor 2007
- Dita e punës, festohet më 1 maj 2008

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi më 3 shtator 2007

Agim Veliu, ministër